


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

5072
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 30/7/2010

UDHËZIM

Nr. 23, datë 30.07.2010

PËR
NJËVLERSHMËRINË E STUDIMEVE NË SHKOLLAT E MESME ME KOHË TË
PLOTË DHE ME KOHË TË SHKURTUAR, NË SISTEMIN PARAUNIVERSITAR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të Ligjit Nr. 7952 datë 21.06.1995 "Për Sistemin Arsimit Parauniversitar" i ndryshuar;

UDHËZOJ:

I. Procedurat, periudha dhe modalitetit e transferimit të nxënësit

1. Nxënësit që mbarojnë klasën 10-të dhe të 11-të, në shkollat profesionale me strukturën 3-vjeçare ose 3+2-vjeçare, nivelin e parë dhe të dytë të strukturës 2+1+1 dhe nivelin e parë të strukturës 2+2 (sipas tabelës bashkëlidhur këtij Udhëzimi), mund të vazhdojnë studimet në gjimnazet me kohë të plotë. Për këtë, ata duhet të plotësojnë planin mësimor të gjimnazit, duke dhënë si provim jo më shumë se 6 (gjashtë) lëndë. Njëherazi, ata duhet të plotësojnë kriterin e moshës të përcaktuar në nenin 11 të Dispozitave Normative të Arsimit Parauniversitar.
2. Nxënësit të cilët kanë përfunduar tre vite të shkollës profesionale, mund të regjistrohen në klasën pasardhëse të shkollës së mesme me kohë të shkurtuar. Në këtë rast këta nxënës janë të detyruar të bëjnë njëvlershmërinë e planit mësimor të

Udhë 17
dat 29.06

- kryer në shkollën e tyre, me planin mësimor të shkollës së mesme me kohë të shkurtuar.
3. Nxënësit regjistrohen në të njëjtin vit, kur kanë më shumë se 6 lëndë për të ekuivalentuar.
 4. Për nxënësit e gjimnazit transferimet bëhen në fillim të semestrit II dhe në fillim të vitit shkollor.
 5. Kur një nxënës transferohet nga një gjimnaz në një tjetër, plani mësimor që ai ka zhvilluar, duhet të përputhet me shkollën pritëse. Në rastin kur shkolla pritëse nuk siguron vazhdimësinë e lëndëve me zgjedhje dhe moduleve kurrikulare të nxënësit që kërkon të transferohet, atëherë transferimi bëhet vetëm në përfundim të vitit shkollor.
 6. Transferimi i nxënësit nga një shkollë e mesme profesionale ose gjimnaz, në një shkollë tjetër të të njëjtit profil ose të profileve të ndryshme, bëhet me kërkesë të prindit ose kujdestarit të nxënësit dhe me miratim të Drejtorive Arsimore Rajonale/Zyrave Arsimore.
 7. Të dyja shkollat (pritëse dhe transferuese) mbajnë shënimet përkatëse në amzë mbi bazën e dokumentacionit dëftesë ose vërtetim notash, si dhe datën e largimit/ardhjes së nxënësit.
 8. Për nxënësit të cilët janë në shkolla me konkurrim (shkollat sportive, shkollat e mesme të muzikës dhe shkollat koreografike), lejohet transferimi i studimeve brenda të njëjtës degë dhe në marrëveshje mes dy drejtorive të shkollave.
 9. Transferimi i studimeve për nxënësit që vazhdojnë shkollën e mesme me kohë të shkurtuar nuk mund të realizohet në asnjë rast.
 10. Dokumentacioni i transferimit ruhet në sekretarinë e shkollës dhe është objekt monitorimi i Inspektoratit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar.

II. Ekuivalentimi dhe transferimi i nxënësve që vijnë nga jashtë shtetit

11. Nxënësit të cilët transferojnë studimet nga jashtë shtetit në Shqipëri, në vitet e ndërmjetme ekuivalentojnë studimet e kryera në shkollën e mesme pranë DAR/ZA të qendrave ku ata banojnë në bazë të dokumentacionit origjinal të përkthyer dhe noterizuar.
12. Kur nxënësit që vijnë nga jashtë shtetit, kanë vijuar mësimet në një shkollë profesionale, gjendet një shkollë e njëjtë ose e përafërt me atë shkollë për të vijuar studimet.
13. Ekuivalentimi kryhet sipas procedurave të parashikuara në Kreun I të këtij Udhëzimi. Nxënësit e kësaj kategorie nuk mund të ripërsërisin lëndë apo kredite për të cilat janë vlerësuar njëherë.

II. Dispozita të fundit

14. Udhëzimi Nr.1, datë 20.01.1999 "Për ekuivalentimin e shkollave profesionale të ristrukturuara të nivelit të parë (3-vjeçar) me shkollat e mesme të përgjithshme" shfuqizohet.

15. Ngarkohet për zbatimin e këtij Udhëzimi, Zëvendësministri për Arsimin Parauniversitar, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MYQEREM TAJ



MINISTËR